



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:182242

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05780709

KPPP.nr.2048/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Arena Trade” SH.P.K., me NUI: 811254078, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Florenti 3” DPT, me NRB: 811305334, me seli në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.344/2022 të datës 22.07.2022, të Përmbartuesit Privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 04.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Florenti 3” DPT, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.344/2022 i datës 22.07.2022, i Përmbartuesit Privat Fadil Hoxha.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.344/2022 i datës 22.07.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Arena Trade” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.344/2022 të datës 22.07.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 21-SHV01-001-183 të datës 13.01.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-178 të datës 13.01.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-744 të datës 27.01.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-989 të datës 03.02.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-983 të datës 03.02.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-1269 të datës 10.02.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-1272 të datës 10.02.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-1752 të datës

24.02.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-1753 të datës 24.02.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-2018 të datës 03.03.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-2019 të datës 03.03.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-2349 të datës 10.03.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-2618 të datës 17.03.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-2612 të datës 17.03.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-3086 të datës 31.03.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-3084 të datës 31.03.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-3378 të datës 07.04.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-3705 të datës 14.04.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-3971 të datës 21.04.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-3972 të datës 21.04.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-3972 të datës 21.04.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-4502 të datës 05.05.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-4499 të datës 05.05.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-5216 të datës 26.05.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-5461 të datës 02.06.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-5457 të datës 02.06.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-6038 të datës 16.06.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-6363 të datës 23.06.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-6356 të datës 23.06.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-6676 të datës 30.06.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-6677 të datës 30.06.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-6999 të datës 07.07.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-7271 të datës 14.07.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-7267 të datës 14.07.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-7808 të datës 28.07.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-8041 të datës 04.08.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-8037 të datës 04.08.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-8362 të datës 11.08.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-8359 të datës 11.08.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-8749 të datës 18.08.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-8742 të datës 18.08.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-9035 të datës 25.08.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-9308 të datës 01.09.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-9303 të datës 01.09.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-9912 të datës 15.09.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-9908 të datës 15.09.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-10181 të datës 22.09.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-11505 të datës 27.10.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-11501 të datës 27.10.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-12112 të datës 17.11.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-12104 të datës 17.11.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-12340 të datës 24.11.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-12532 të datës 01.12.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-12540 të datës 01.12.2021 dhe Faturës Nr. 21-SHV01-001-12756 të datës 08.12.2021; me të cilën është detyruar debitori që menjëherë nga dita e pranimit të urdhrimit të paguaj kreditorit shumën prej 3,547.13 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përbaruesit privat, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, duke deklaruar se palët kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, ku kreditori ka marrë përsipër që në baza të rregullta ta furnizoj debitorin me produkte të ndryshme në kompensim të kundërvlerës financiare, si dhe palët ishin pajtuar që duke u mbështetur në rregullat e dokeve të mira afariste në çdo fundvit apo fillimin e vitit kalendarik të bëjë barazimin financiar, por që në rastin konkret kreditori nuk i ka përmbushur këto obligime. Më tutje ka theksuar se faturat nuk janë të përshtatshme si dokument përmbarimor, sepse koha e përmbushjes së detyrimit është e lidhur ngushtë me barazimin e obligimeve financiare. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, të prishet urdhri për lejimin e përmbarimit, si dhe të abrogohen të gjitha veprimet juridike.

Kreditore në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se qëllimi i saj është vetëm shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit që debitori e ka ndaj kreditorit. Më tutje ka theksuar se faturat e lartcekura kanë të gjitha tiparet e përmbarueshmërisë. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti*

i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm: Faturën Nr. 21-SHV01-001-183 të datës 13.01.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-178 të datës 13.01.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-744 të datës 27.01.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-989 të datës 03.02.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-983 të datës 03.02.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-1269 të datës 10.02.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-1272 të datës 10.02.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-1752 të datës 24.02.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-1753 të datës 24.02.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-2018 të datës 03.03.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-2019 të datës 03.03.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-2349 të datës 10.03.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-2618 të datës 17.03.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-2612 të datës 17.03.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-3086 të datës 31.03.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-3084 të datës 31.03.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-3378 të datës 07.04.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-3705 të datës 14.04.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-3971 të datës 21.04.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-3972 të datës 21.04.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-3972 të datës 21.04.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-4502 të datës 05.05.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-4499 të datës 05.05.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-5216 të datës 26.05.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-5461 të datës 02.06.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-5457 të datës 02.06.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-6038 të datës 16.06.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-6363 të datës 23.06.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-6356 të datës 23.06.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-6676 të datës 30.06.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-6677 të datës 30.06.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-6999 të datës 07.07.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-7271 të datës 14.07.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-7267 të datës 14.07.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-7808 të datës 28.07.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-8041 të datës 04.08.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-8037 të datës 04.08.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-8362 të datës 11.08.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-8359 të datës 11.08.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-8749 të datës 18.08.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-8742 të datës 18.08.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-9035 të datës 25.08.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-9308 të datës 01.09.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-9303 të datës 01.09.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-9912 të datës 15.09.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-9908 të datës 15.09.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-10181 të datës 22.09.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-11505 të datës 27.10.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-11501 të datës 27.10.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-12112 të datës 17.11.2021; Faturën Nr. 21-

SHV01-001-12104 të datës 17.11.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-12340 të datës 24.11.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-12532 të datës 01.12.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-12540 të datës 01.12.2021 dhe Faturën Nr. 21-SHV01-001-12756 të datës 08.12.2021; të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi si dhe të njëjtat janë bërë të arritshme për pagesë.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, si dhe mbajnë nënshkrimin si dhe vulën e pranimit nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit për kohën e përmbushjes së detyrimit monetar dhe gjeti se e njëjta nuk gjen mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë. Për më tepër fatura e cila nuk përmban afat të përmbushjes nga data e lëshimit të faturës, nënkuptohet se afati për përmbushje arrin menjëherë respektivisht në datën e lëshimit të faturës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2048/23, datë 04.06.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.